



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 1025/1 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 71, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 28, DATË 9.4.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 28, datë 9.4.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Librazhd dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr.102, datë 07.12.2023, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Librazhd”*, Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi në institucionin Bashkia Librazhd.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 28, datë 09.04.2024, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Librazhd dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*, të Komisionerit, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, në institucionin Bashkia Librazhd, me urdhrin nr. 130, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 28, datë 9.4.2024, të Komisionerit”*, sipas objektit dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri. Për nisjen e këtij procesi Bashkia Librazhd është njoftuar me shkresën nr. 951/2 prot., datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues nr. 28, datë 9.4.2024, të Komisionerit”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Në vijim, me urdhrin nr. 51, datë 18.06.2025, *“Për zhvillimin e seancave dëgjimore në kuadër të masave për zbatimin e vendimeve paralajmëruese”*, të Komisionerit, njoftuar Bashkisë Librazhd me shkresën nr.626/5 Prot., datë 18.06.2025, Komisioneri ka urdhëruar, ndër të tjera, zhvillimin e një seance dëgjimore në datën **25.06.2025, ora 10:00**, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtij subjekti, me qëllim vlerësimin e masave të marra për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 28, datë 9.04.2024. Ky proces është dokumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë seancë, ku është evidentuar situata në lidhje me masat e marra nga institucioni.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 28, datë 09.04.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, përfshirë komunikimin shkresor, konstatoj se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrtur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, Komisioneri ka kërkuar që Njësia përgjegjëse e institucionit (*Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore*), të veprojë si më poshtë:

- Të përcaktojë nëpunësin civil/grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni.
- Ky material t’u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (*epropri direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Sekretari i Përgjithshëm*).

Konstatoj se, me shkresën nr. 2262 prot., datë 10.05.2024, të gjitha njësitë drejtuese të institucionit janë njoftuar për hartimin e përshkrimeve të pozicioneve të punës.

Në pikat 3, 4, 5 dhe 6, Komisioneri ka kërkuar që:

- pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës (*Struktura dhe organika e hollësishme e institucionit që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit dhe përshkrimet e punës për vendet e punës pjesë e shërbimit civil*). Ky dokumentacion t'i përcillet Komitetit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil.
- Sekretari i Përgjithshëm të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil.
- Komiteti i vlerësimit pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm të identifikojë me saktësi vendet e punës që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit; të vijojë punën me vlerësimin e tyre bazuar në përshkrimet e punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave.
- Në përfundim të procesit të vlerësimit të hartohet një listë përmbledhëse ku të pasqyrohen pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse.
- Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante të shërbimit civil. Në këtë akt të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi.

Rezulton se, me urdhrin nr. 556, datë 06.06.2024, Sekretari i Përgjithshëm ka ngritur Komitetin e Vlerësimit dhe Klasifikimit të Pozicioneve të Punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Po kështu, vërej se plani vjetor i pranimi në shërbimin civil është miratuar nga Drejtori i Burimeve Njerëzore të institucionit, me aktin nr. 1022 prot., datë 20.02.2025.

Në pikën 7, Komisioneri ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Njësia përgjegjëse e institucionit të hartojnë dhe miratojnë një plan veprimi për zbatimin e këtij vendimi paralajmërues, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna në raportin përfundimtar dhe në këtë vendim; b) subjekti/nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit; si dhe, c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrativ. Planin e veprimit do të dërgohet pranë Komisionerit 30 ditë, pas marrjes dijeni për këtë vendim paralajmërimi.

Vërej se, me shkresën nr. 4769/1 prot., datë 26.11.2025, "*Dërgohet informacion në lidhje me sa kërkohet në shkresën tuaj me nr. 739 prot., datë 09.07.2025, për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të Komisionerit nr. 28, datë 09.04.2024*", regjistruar pranë

Komisionerit me nr. 739/1 prot., datë 02.12.2025, institucioni ka informuar Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të vendimit paralajmërues. Në përmbajtjen e kësaj shkrese, ndër të tjera, Bashkia Librazhd informon se është hartuar dhe miratuar plani i veprimit për zbatimin e detyrave të lëna nga ana e Komisionerit, i paraqitur në vijim të kësaj shkrese në trajtë tabelore.

Në pikën 8, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, që në përfundim të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për të gjithë punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e ligjit nr. 152/2013, të cilët aktualisht përbëjnë 68 raste.

Nga aktet e administruara konstatohet se institucioni i Bashkisë Librazhd ka ndërmarrë disa hapa për përmbushjen e kësaj pike ndër të cilat janë vendimet e Kryetarit të Bashkisë, si vijon:

1. **Arjan Tola**, “*Specialist*” në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore (Vendim nr. 1).
2. **Ada Biçaku**, “*Specialist*” për Sigurinë Ushqimore në Drejtorinë e Bujqësisë, Ushqimit, Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit (Vendim nr. 2, datë 20.02.2024).
3. **Ani Teta**, “*Specialist*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Pyjeve (Vendim nr. 3, datë 20.02.2024).
4. **Artenca Gjura**, “*Jurist*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Urbanistikës (Vendim nr. 4, datë 20.02.2024).
5. **Adela Haskurti**, “*Specialist*” në Sektorin e Urbanistikës, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (Vendim nr. 5, datë 20.02.2024).
6. **Genci Topi**, “*Specialist*” në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore (Vendim nr. 6, datë 20.02.2024).
7. **Marsida Muça**, “*Specialist*” në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Pyjeve (Vendim nr. 7, datë 20.02.2024).
8. **Rezearta Hunçi**, “*Specialist*” për Barazinë Gjinore në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Mbrojtjes Sociale (Vendim nr. 8, datë 20.02.2024).
9. **Fatime Mema**, “*Specialist*” për Sigurinë Ushqimore në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit (Vendim nr. 9, datë 20.02.2024).
10. **Drilona Bufi**, “*Specialist*” në Sektorin e Financës, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (Vendim nr. 10, datë 20.02.2024).
11. **Ilmi Çepi**, “*Specialist*” mjedisi në Sektorin e Menaxhimit të Ujrave (Vendim nr.11, datë 20.02.2024).
12. **Ervis Nezha**, “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (Vendim nr. 12, datë 20.02.2024).
13. **Naxhije Kaca**, “*Specialist*” në Sektorin e Bujqësisë (Vendim nr. 13, datë 20.02.2024).
14. **Ervis Sejдини**, “*Specialist*” në Drejtorinë e Bujqësisë, Ushqimit, Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit (Vendim nr. 14, datë 20.02.2024).
15. **Klorida Lleshi**, “*Specialist*” në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike (Vendim nr. 15, datë 20.02.2024).

16. **Lavdurie Hoxha**, “*Specialist*” në Drejtorinë e Projekteve, Integritetit Europian dhe Informimit Publik (Vendim nr. 16, datë 20.02.2024).
17. **Ina Hoxha** “*Specialist*” në Sektorin e Auditit të Brendshëm (Vendim nr. 17, datë 20.02.2024).
18. **Elton Faqolli**, “*Specialist*” në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore (Vendim nr.18, datë 20.02.2024).
19. **Pëllumb Zharri**, “*Specialist*” në Sektorin e Mbrojtjes Civile (Vendim nr. 19, datë 20.02.2024).
20. **Mersin Golikja**, “*Specialist*” në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore (Vendim nr.20, datë 20.02.2024).
21. **Kujtim Kurti**, “*Specialist*” Bujqësie në Njësinë Administrative Qendër (Vendim nr. 21, datë 20.02.2024).
22. **Ardit Kullafi**, “*Specialist*” në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave (Vendim nr. 22, datë 20.02.2024).
23. **Elida Karaj**, “*Specialist*” administrator shoqëror në Njësinë Administrative Qendër (Vendim nr. 23, datë 20.02.2024)

Nga komunikimi elektronik i datës 05.12.2025 me njësinë përgjegjëse, vërej se institucioni ka kryer disa shpallje për pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil që janë vakante, por nga verifikimi në faqen zyrtare të internetit të institucionit, nuk rezulton që ato të jenë publikuar në të. Njëkohësisht, njësia përgjegjëse e Bashkisë Librazhd, nuk ka dërguar aktin që provon që këto shpallje i janë dërguar për publikim AKPA-së.

Në **pikën 9** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që njësia përgjegjëse të anulojë aktet e konfirmimit të punonjësve për të cilët është konstatuar se janë konfirmuar në detyrë pa respektuar procedurat ligjore të periudhës së provës, si dhe të rifillojë procesin në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Në këtë kuadër, është kërkuar që vendimi i konfirmimit të merret nga eprori direkt, si organi kompetent sipas ligjit, ndërsa zyrtarët vlerësues të plotësojnë formularët e vlerësimit në mënyrë të plotë, objektive dhe të arsyetuar, duke reflektuar të gjitha fazat dhe kriteret e detyrueshme të procesit të vlerësimit gjatë periudhës së provës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatoj se:

- Me Vendimin nr. 26, datë 25.07.2024, është liruar nga shërbimi civil z. Mehmet Bardhoshi, në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Mbrojtjes Civile.
- Me Vendimin nr. 21, datë 15.02.2023, është ndërprerë marrëdhënia e punës me znj. Mentiana Tanushi, në pozicionin “*Specialist*” në Njësinë e Auditit të Brendshëm.
- Me Vendimin nr. 23, datë 27.03.2024, është pezulluar nga shërbimi civil z. Erjon Qose, në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit.
- Me Urdhrin nr. 1032, datë 08.11.2023, është ndërprerë marrëdhënia e punës, me dorëheqje, për z. Jurgen Mema, në pozicionin “*Përgjegjës*” në Sektorin i Urbanistikës.

- Me Vendimin nr. 15, datë 09.10.2024, është pezulluar nga shërbimi civil z.Klodian Daja, në pozicionin “*Specialist Administrator Shoqëror*” në NJA Hotolisht.
- Me Vendimin nr. 3, datë 21.12.2023, është liruar nga shërbimi civil z. Marion Kushi, në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Ndhmës Ekonomike.

Gjithashtu, vërej se në disa raste janë bërë emërimet të përkohshme në pozicione pune jashtë shërbimit civil. Konkretisht:

- Me Urdhrin nr. 892, datë 30.09.2024, për znj. Besjana Mnalla, emëruar në pozicionin “*Specialiste*” në Sektorin e Shërbimeve Sociale.
- Me Urdhrin nr. 875, datë 26.09.2024 për znj. Merita Dashballa, emëruar në pozicionin “*Specialiste*” në Drejtorinë e Integritetit.
- me Urdhrin nr. 896, datë 30.09.2024 për z. Bledar Çota, emëruar në pozicionin “*Kryeinspektor*” në Inspektoratin e Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave.
- me Urdhrin nr. 874, datë 26.09.2024 për znj. Erda Poçi, emëruar në pozicionin “*Specialiste*” në Sektorin e Planifikimit.
- me Urdhrin nr. 955, datë 09.10.2024 për znj. Ervisa Llapushi, emëruar në pozicionin “*Specialiste e Aftësisë së Kufizuar*” NJA Hotolisht.

Në përfundim në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, rezulton se Bashkia Librazhd ka filluar zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 28, datë 9.4.2024, të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë. Problematika në këtë rast, qëndron kryesisht në drejtim të dy aspekteve të administrimit të shërbimit civil, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, edhe pse, nga institucioni janë marrë masa për t’i nisur dhe zhvilluar këto procese, por ende ato nuk janë finalizuar me akte përfundimtare.

Në kushtet kur këto procese kanë një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se këto procese kërkojnë një periudhë kohore relativisht të gjatë për t’u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t’i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Me synim plotësimin e detyrave të lëna në vendim, në koherencë edhe me zhvillimet aktuale, që përkohë me hartimin e strukturave të reja organizative të njësisë të administratës vendore për vitin 2026, si edhe me qëllim që këto institucione të mbështeten me asistencë teknike si nëpërmjet trajnimeve nga ASPA, ashtu edhe nga stafi i Komisionerit, për të zbatuar drejt kërkesat e ligjit dhe procedurat ligjore rast pas rasti,

vlerësojmë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë, përgjatë vitit 2026, duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për implementimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në përbërje të strukturës organizative në njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat janë procese që aktualisht realizohen nga stafi i Komisionerit, përgjatë gjithë vitit kalendarik.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 28, datë 9.4.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Librazhd dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”*.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Librazhd.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha